

V E N D I M
Nr. 387, datë 14.7.2000

PËR RITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1996, “Mbi sigurimet shoqërore shtetërore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas nenit 96, paragrafi i katërt i ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, ndryshon si vijon:

2. Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi, me masë pensioni mujor:

- deri në 4 400 lekë rriten 17 për qind.
- nga 4 401 lekë deri në 4 556 lekë bëhen 5 148 lekë.
- nga 4 557 lekë deri në 5 242 lekë rriten 13 për qind.
- nga 5 243 lekë deri në 5 385 lekë bëhen 5 923 lekë.
- mbi 5 386 lekë e lart rriten 10 për qind.

3. Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 15 për qind.

4. Pensionet shtetërore të posaçme dhe shtesa e pensioneve të posaçme shtetërore rriten në masën 10 për qind.

5. Shtesa mujore e përfutur nga vendimi nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, rriten në masën 10 për qind.

6. Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen, duke filluar nga data 30.6.2000 duke përfshirë edhe këtë datë.

7. Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 5 148 lekë në muaj.

8. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr.758, datë 1.2.1994, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” rriten në masën 15 për qind.

9. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara, sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, (i ndryshuar), rriten në masën 15 për qind.

10. Pensioni i plotë i pleqërisë dhe pensioni i plotë i invaliditetit, që caktohet sipas paragrafit të katërt të nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, duke filluar nga data 1.7.2000 e në vazhdim nuk llogariten më pak se 1 328 lekë në muaj.

11. Efektet financiare nga rritja e pensioneve janë 1 645 milionë lekë dhe përballohen nga:

- fondi i sigurimeve shoqërore i miratuar në buxhetin e vitit 2000, në shumën 1 043.5 milionë lekë.

- teprica e fondit të sigurimeve shoqërore e vitit 1999 në shumën 226 milionë lekë.

- fondet e planifikuara për koston e ristrukturimit të bankave në shumën 375.5 milionë lekë.

12. Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zërin “shpenzime”, i shtohen 601.5 milionë lekë.

13. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse.

14. Për përballimin e vëllimit të punës, për rritjen e pensioneve, Institutit të Sigurimeve Shoqërore i shtohen në fondin e pagesës 3 milionë lekë, të cilat të përballohen brenda buxhetit të shpenzimeve administrative të tij në vitin 2000.

15. Vendimi i shtrin efektet financiare, nga data 1.7.2000.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta